



Hulumtim Politikash

Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit
2010-2011



Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur – KFOS. Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e KFOS.

Hulumtim Politikash

Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit
2010-2011

Përmbajtja:

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. HYRJE	6
3. METODOLOGJIA	7
4. VENDIMET E QEVERISË NË LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT	8
5. VENDIMI I PARË: THEMELIMI I TASK-FORCËS ANTIKORRUPSION	9
5.1.1. Mungesa e hulumtimeve dhe studimeve paraprake	10
5.1.2. Emërtimet e llojllojshme për Task-Forcën	10
5.1.3. Përbërja e përzier e prokurorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë	11
5.1.4. Korniza e pa definuar e fushëveprimit ligjor dhe funksionimi përbrenda PSRK-së	12
5.1.5. Profili i ulët i zyrtarëve të akuzuar për vepra korruptive	13
5.1.6. Mungesa e transparencës dhe mos-bërja publike e rezultateve	15
6. VENDIMI I DYTË: RRRITJA E 17 POZITAVE PËR AAPSK	16
7. VENDIMI I TRETË: LIGJI PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË DHE DHURATAVE TË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIKË	18
8. VENDIMI I KATËRT: LIGJI PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE	19
9. VENDIMI I PESTË: LIGJI PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE	20
10. VENDIMI I GJASHTË: LIGJI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT	21
11. REKOMANDIME	23
12. FALËNDERIME	24
13. RRETH LËVZIJES FOL	24

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

AAPSK - Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar

AUV - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

DG - Doganat e Kosovës

DSA - Departament Special Anti-Korrupsion

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

GPLKK - Grupi i Prokurorëve në Luftë Kundër Korrupsionit

KDI - Instituti Demokratik i Kosovës

KPMM - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

KPPK - Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës

LMI - Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve

LFSP - Ligji për Financimin e Subjekteve Politike

LMI - Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve

MD - Ministria e Drejtësisë

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MSH - Ministria e Shëndetësisë

PSRK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

PK - Policia e Kosovës

PTK - Post-Telekomi i Kosovës

TFA - Task-Forca Anti-Korrupsion

TI - Transparency International (Transparenca Ndërkombëtare)

Përmbledhje Ekzekutive

Ky hulumtim politikash dëshmon mungesën e seriozitetit të Qeverisë që të nxjerrë vendime të qëndrueshme në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Të gjashtë vendimet e analizuar, dy të nxjerra për konsolidimin e kornizës institucionale dhe katër sosh për kompletimin e kornizës ligjore anti-korrupsion, tregojnë mungesën e përgjithshme të ndikimit që do të duhej ato të kishin në uljen e shkallës së korrupsionit në institucionet publike.

Të gjeturat hulumtimit argumentojnë se mangësitë e shumta që kanë shoqëruar fazën e nxjerrjes së vendimeve kanë prodhuar më pas keqfunksionimin e institucioneve në luftë kundër korrupsionit, si dhe e kanë bërë të pamundur zbatueshmërinë e dispozitave ligjore në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Ndër dobësitë kryesore që kanë shoqëruar vendimin e parë për Themelimin e Task-Forcës Anti-Korrupsion janë:

- a. mungesa e analizave dhe studimeve paraprake që do të arsyetonin themelimin e një mekanizmi të tillë në luftë kundër korrupsionit;
- b. emërtimet e llojllojshme dhe paqartësitë e tjera mbi karakterin e këtij mekanizmi;
- c. përbërja e përzier e prokurorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë (moskoordinimi dhe mos-lejimi i prokurorëve vendorë në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë më nivelin e lartë të zyrtarëve publikë);
- d. korniza e pa definuar e fushëveprimit ligjor dhe funksionimi përbrenda PSRK-së;
- e. profil i ulët i zyrtarëve të akuzuar për vepra korruptive; si dhe
- f. mungesa e transparencës dhe mos-bërja publike e punës së tyre në luftë kundër korrupsionit.

Në rastin e dytë, atë të kompletimit të stafit (17 pozita) për Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruar apo të Konfiskuar, dobësitë kryesore që kanë shoqëruar Agjencinë gjatë funksionimit të saj trevjeçar janë:

- a. mungesa e specializimit në administrimin e pasurive që burojnë kryesisht nga korrupsioni, krimi i organizuar dhe shpëlarja e parasë;
- b. mungesa e ekzekutimit të vendimeve për konfiskim apo sekuestrim të pasurisë; dhe
- c. mungesa e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet Agjencisë dhe prokurorive, gjykatave dhe institucioneve tjera relevante.

Sa i përket vendimit të tretë, për ndryshimin e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, problemet kryesore me këtë ligj mbeten edhe më tutje:

- a. mungesa e sanksioneve të ashpra sa i përket mos-deklarimit të pasurisë;
- b. mungesa e verifikimit të saktësisë së deklaratave; dhe
- c. pamundësia për ta kontrolluar prejardhjen apo origjinën e pasurisë që mund të jetë fituar me veprime të kundërligjshme.

Hulumtim Politikash: Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit

Dobësi të shumta kanë shoqëruar edhe vendimin për Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve.

- a. mangësia fillestare e këtij ligji ka të bëjë me vetë emërtimin e tij. Në vend që të quhej Ligji për Mbrojtjen e Zyrtarëve që Raportojnë Korrupsionin, ligji është emërtuar 'Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve'. Një emërtim i tillë ndërlidhet me persona që operojnë në kuadër të shërbimeve inteligjente/sekrete;
- b. së dyti, ligji në fjalë nuk përcakton ndonjë institucion apo komision të posaçëm në të cilin do të mund të raportoheshin praktikat e dyshimta abuzive nga ana e zyrtarëve institucionale; dhe
- c. së treti, por që është më e rëndësishmja, ligji nuk e qartëson mbrojtjen e identitetit të informatorit dhe as nuk e penalizon situatën kur një institucion apo zyrtar përkatës e zbulon anonimitetin e informatorit që denoncon një veprim abuziv.

Në rastin e vendimit të pestë, për ndryshimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, ndryshimet e bëra kanë prekur disa fusha të rëndësishme. Derisa në ligjin paraprak "shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike nuk mund të kalonte 0,17 % të Buxhetit, në ligjin e ri kjo shumë është dyfishuar - 0,34%. Po ashtu, dispozitat ndëshkimore të ligjit të ri janë ashpërsuar më shumë krahasuar me ato të ligjit paraprak. Derisa në ligjin e mëparshëm shuma sanksionuese ka qenë prej 3,000.00 - 10,000.00 €, në ligjin e tanishëm është përcaktuar prej 5,000.00 - 50,000.00 €. Një dispozitë tjetër e rëndësishme sanksionuese është edhe ajo për mos-raportim të financave brenda afatit të përcaktuar me ligj. "Nëse një subjekt politik nuk e paraqet raportin vjetor financiar (...) humb të drejtën për të përfitur nga fondi në vitin e ardhshëm" (neni 21, paragrafi 2).

Ndërkaq me rastin e vendimit të gjashtë, atë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dy plotësim/ndryshime pozitive kanë ndodhur:

- zvogëlimi i përqindjes së aksioneve (nga 20 % në 5 %) që një zyrtar publik mund të posedojë; dhe
- ashpërsimi i sanksioneve në rastet kur zyrtarët publikë gjenden në konflikt interesi (shkarkimi nga funksioni publik dhe/ose gjoba prej 500.00 € deri në 2500.00 €).

Bazuar në Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsion (2011), e cila është edhe instanca kryesore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, rezulton se përgjatë vitit 2011 janë evidentuar 54 raste të konfliktit të interesit. Prej tyre në 23 raste është shmangur konflikti i interesit; 13 raste kanë rezultuar pa konflikt të interesit; 7 raste kanë rezultuar me opinion; ndërsa tre (3) raste të trajtuara kanë përfunduar me shkarkim nga funksioni; dhe një (1) rast është dërguar në kundërvajtje. Raste që janë në procedurë të trajtimit dhe të pa përfunduara janë 7, të cilat janë bartur në vitin 2012.

I. Hyrje

Menjëherë pas ardhjes në pushtet, në janar të vitit 2008, kryeministri Thaçi pati premtuar se "kabineti i tij qeveritar do të jetë shumë i përkushtuar për ta luftuar korrupsionin".¹ Kjo, sipas tij, "do të ishte pjesë e filozofisë së qeverisë së re dhe pjesë e betejës në luftë kundër korrupsionit dhe kundër dukurive negative".² Një vit më vonë, saktësisht në janar të vitit 2009, kryeministri Thaçi përsëriti prapë publikisht prioritetin e qeverisë së tij për "tolerancë zero ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit".³ Në vitin pasues, përkatësisht në 2010, kryeministri Thaçi pati shprehur sërish zotimin se "institucionet e Kosovës do ta udhëheqin luftën kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar dhe të gjitha dukurive tjera negative".⁴ Për më tepër, përgjatë këtij viti ai pati premtuar se "unë do të vazhdoj të jem udhëheqës i kësaj beteje me mbështetje të plotë nga të gjitha institucionet kosovare, të rendit dhe ligjit dhe përgjegjës i bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha autoritetet ndërkombëtare".⁵ Ky 'prioritet', i luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, nuk është lënë anash as në vitin 2011. Vetë kryeministri Thaçi pati deklaruar "tolerancë zero ndaj korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare për qëllime të përfuturit personal...".⁶ Pesë vjet më vonë nga 2008-ta, kryeministri nuk ngurroi aspak të përsërisë sërish se "prioritetet kryesore për vitin 2012 do të vazhdojnë të mbeten lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar".⁷

Siç e shohim edhe nga deklaratimet e lartpërmendura, prej vitit 2008 e deri me tash 'prioriteti' kryesor i kryeministrit Thaçi dhe qeverisë së tij 'ka qenë dhe vazhdon të mbetet luftimi dhe parandalimi i korrupsionit'. Megjithatë, si mund të jetë prioritet luftimi i një fenomeni (korrupsionit) në vitin 2008, të vazhdojë më pas përgjatë viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012, ndërkaq korrupsioni në institucionet publike të jetë prapë në nivelet e tija më të larta? Nëse lufta e tillë është vendosur si prioritet në vitin 2008, pra, dhe ka vazhduar të jetë sërish edhe në vitin 2012, e kuptojmë se luftimi i korrupsionit s'ka qenë prioritet as në vitin 2008 dhe as që mund të jetë si i tillë në vitin 2012. Sipas përkufizimit të fjalorit të Oxfordit, "prioritet konsiderohet një fakt ose një gjendje që trajtohet si më e rëndësishme sesa të tjerat".⁸ Nëse luftimi i korrupsionit do të ishte njëmend pra prioritet i qeverisë, niveli i tij në institucionet publike do të minimizohej dhe vendi ynë nuk do të renditej më si vendi më i korruptuar në Ballkan dhe Evropë.

¹ Qeveria e Kosovës. "100 ditët e kryeministrit Thaçi." Prishtinë, 2008, fq. 8.

² Ibid. fq. 11.

³ Qeveria e Kosovës. <http://www.kryeministri-ks.net>. Janar 9, 2009. <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,104,38>.

⁴ Qeveria e Kosovës. <http://www.kryeministri-ks.net>. Maj 31, 2010. <http://www.kryeministri-ks.net/index.php?page=1,9,1358>.

⁵ Ibid.

⁶ Partia Demokratike e Kosovës. Fjalimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e rizgjedhjes kryeministër i Republikës së Kosovës. 02 22, 2011. [http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-repuPartia Demokratike e Kosovës. Fjalimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e rizgjedhjes kryeministër i Republikës së Kosovës. 02 22, 2011. http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-republik%C3%ABs-s%C3%AB-kosov%C3%ABs-hashim-tha%C3%A7i-me-rastin-e-rizgje/203125783033302](http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-repuPartia%20Demokratike%20e%20Kosov%C3%AB-fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-republik%C3%ABs-s%C3%AB-kosov%C3%ABs-hashim-tha%C3%A7i-me-rastin-e-rizgje/203125783033302). blik%C3%ABs-s%C3%AB-kosov%C3%ABs-hashim-tha%C3%A7i-me-rastin-e-rizgje/203125783033302.

⁷ Gazeta Zëri. www.zeri.info. Janar 5, 2012. <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/41430/thaci-2012-vit-i-luftimit-te-korrupsionit/>.

⁸ Fjalori i Oxfordit. <http://oxforddictionaries.com/definition/english/priority> (i qasur me 2 Tetor, 2012).

2. Metodologjia

Ky hulumtim politikash nxjerrë në pah ndikimin e vendimeve kryesore të qeverisë në luftë kundër korrupsionit që janë miratuar përgjatë viteve 2010 dhe 2011. Metodologjia e përdorur është ndërtuar në shfrytëzimin e instrumenteve të ndryshme: analizim të dokumenteve, aktiviteteve dhe politikave qeveritare, realizim të intervistave me prokurorë dhe përfaqësues të organizatave jo-qeveritare, hulumtim të vlerësimeve ndërkombëtare për nivelin e korrupsionit në institucionet publike, si dhe monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve institucionale në luftë kundër korrupsionit.

Hulumtimi është ndarë në dy faza: a) në hulumtimin e kornizës institucionale dhe b) legjislacionin kundër korrupsionit. Në kuadër të fazës së parë, atë të kornizës institucionale, është bërë analizimi i vendimit të qeverisë për Themelimin e Task-Forcës Anti-Korrupsion dhe ai për Shtimin e Pozitave në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar apo të Sekuestruar.

Në rastin e parë, atë të TFA-së, është hulumtuar infrastruktura ligjore e fushëveprimit të saj, duke përfshirë vendimin e qeverisë për themelimin e saj, Ligjin për Prokurorinë Speciale dhe Kodin e Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës. Këtu është hulumtuar nëse vendimi i Qeverisë është bazuar paraprakisht në ndonjë propozim të identifikuar nga institucione përkatëse, apo ka qenë thjesht një vendim i atypëratyshëm dhe i pamenduar mirë nga ana e Qeverisë. Më pas kemi analizuar Ligjin për Prokurorinë Speciale, brenda të cilit institucion edhe funksionon TFA, si dhe Kapitullin e XXIX të KPPK që normon të gjitha kategoritë e veprave penale të korrupsionit. Këtu është shikuar nëse kompetencat ligjore që gëzon Prokuroria Speciale janë në pajtueshmëri me misionin për të cilën vetë Task-Forca Anti-Korrupsion është themeluar, si dhe nëse aktet akuzuese që Task-Forca Anti-Korrupsion ka ngritur përfshijnë nivel më të lartë të zyrtarëve publikë sesa ato të ngritura nga Grupi i Prokurorëve në Luftë Kundër Korrupsionit (që funksionon në kuadër të prokurorive të qarkut dhe atyre komunale). Gjatë kësaj faze janë realizuar edhe një sërë intervistash me prokurorë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, në mënyrë që të gjeturat e hulumtimit të jenë sa më objektive dhe sa më të qëndrueshme.

Në rastin e dytë, atë të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar, është parë sesa Agjencia në fjalë është specializuar në administrimin e pasurisë që derivon kryesisht nga krimi i organizuar dhe shpëlarja e parasë. Këtu janë shqyrtuar vlerat e administruara nga ana e kësaj Agjencie, të realizuara gjatë viteve 2010-2012, si dhe aspekti cilësor i pasurive të administruara.

Ndërkaq faza tjetër e hulumtimit ka përfshirë legjislacionin në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit. Këtu është analizuar pakoja ligjore që është propozuar nga Qeveria dhe miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Janë analizuar ligjet që më parë nuk kanë qenë pjesë e legjislacionit, si dhe ligjet që kanë qenë pjesë por që kanë pësuar plotësim-ndryshime. Në pjesën e parë, sa i përket ligjeve të reja që i janë shtuar pakos ligjore anti-korrupsion, është analizuar vetëm Ligji për Informatorët.⁹ Këtu janë

⁹Kuvendi i Kosovës. Gusht 31, 2011. <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,674> (i qasur me 7 Qershor, 2012).

Hulumtim Politikash: Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit

shikuar dobësitë e këtij ligji, duke filluar nga emërtimi i tij, kanalet e rrjedhjes së informacioneve dhe masat mbrojtëse që sigurohen për zyrtarët që denoncojnë aferat e ndryshme korruptive. Po ashtu, është bërë një krahasim me praktikën dhe standardet e vendeve në regjion sa i përket rregullimit të kësaj problematike.

Në pjesën e dytë, atë të ligjeve që kanë pësuar plotësim-ndryshime, është analizuar Ligji për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike. Analiza tregon dispozitat e reja që kanë hyrë në fuqi pas ndryshimit të tyre në vitin 2011, si dhe nëse ndryshimet e realizuara janë bërë vetëm sa për sy e faqe apo ndryshimet e tilla kanë qenë të bazuara në praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Në fund të kësaj analize janë dhënë edhe një sërë rekomandimesh, të cilat nëse do të gjejnë konsideratë nga institucionet gjegjëse do mund të ndikonin në uljen e nivelit të korrupsionit në institucionet publike.

3. Vendimet e Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit 2010-2011

Menjëherë pas ardhjes në pushtet, në janar të vitit 2010, kryeministri Thaçi pati dhënë premtimin e tij se "institucionet e Kosovës do ta udhëheqin luftën kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar dhe të gjitha dukurive tjera negative".¹⁰ Për më tepër, përgjatë këtij viti ai pati premtuar se "unë do të vazhdoj të jem udhëheqës i kësaj beteje me mbështetje të plotë nga të gjitha institucionet kosovare, të rendit dhe ligjit dhe përgjegjës i bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha autoritetet ndërkombëtare".¹¹ Një vjet më vonë, përkatësisht në vitin 2011, kryeministri pati deklaruar "tolerancë zero ndaj korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare për qëllime të përfimit personal...".¹²

Përvec retorikës së vijueshme në luftë kundër korrupsionit, kryeministri Thaci dhe qeveria e tij kanë nxjerrë edhe një sërë vendimesh në luftë kundër korrupsionit, vendime këto të cilat më pas janë përdorur për të treguar gjoja 'përkushtimin' e saj në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Prej vendimeve më të rëndësishme të saj që janë miratuar përgjatë vitit 2010 dhe 2011 hyjnë 2 (dy) për konsolidimin e kornizës institucionale: a) themelimi i Task-Forcës Antikorrupsion dhe b) Rritja e buxhetit dhe numrit të stafit (17 pozita) për Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuara. Ndërkaq të 4 (katër) vendimet e tjera kanë qenë për kompletimin e legjislacionit në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit: a) Projektligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë; b) Projektligji për Mbrojtjen e Informatorëve (whistle blowers law); c) Projektligji

¹⁰ Qeveria e Kosovës. <http://www.kryeministri-ks.net>. Maj 31, 2010. <http://www.kryeministri-ks.net/index.php?page=1,9,1358>.

¹¹ Po aty

¹² Partia Demokratike e Kosovës. Fjalimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e rizgjedhjes kryeministër i Republikës së Kosovës. 02 22, 2011. [http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-repuPartia Demokratike e Kosovës. Fjalimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e rizgjedhjes kryeministër i Republikës së Kosovës. 02 22, 2011. <http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-republik%C3%AB-s-s%C3%AB-kosov%C3%ABs-hashim-tha%C3%A7i-me-rastin-e-rizgje/203125783033302>. <http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-republik%C3%AB-s-s%C3%AB-kosov%C3%ABs-hashim-tha%C3%A7i-me-rastin-e-rizgje/203125783033302>.](http://sq-al.facebook.com/notes/partia-demokratike-e-kosoves-pdk/fjalimi-i-kryeministrit-t%C3%AB-repuPartia%20Demokratike%20e%20Kosoves)

për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; si dhe d) Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike. Në shikim të parë, një numër kaq i madh i këtyre vendimeve¹³ do të mund të kuptohet si një angazhim serioz i qeverisë për ta luftuar korrupsionin, por hulumtimi tregon megjithatë se të gjitha vendimet e lartcekura janë shoqëruar me dobësitë të shumta, që nga faza e nxjerrjes së tyre e deri të niveli praktik i zbatimit të tyre.

4. Vendimi i Parë: Themelimi i Task-Forcës Anti-Korrupsion

E përballur me kritika të shumta për mungesë rezultatesh në luftë kundër korrupsionit, qeveria Thaçi (përmes një vendimi në shkurt të vitit 2010) pati kërkuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ta themelojë një Departament Special Anti-Korrupsion (DSA). Një vendim i tillë është marrë atëbotë “si sinjal i fuqishëm i qeverisë në luftimin e korrupsionit”.¹⁴ Vetë kryeministri Thaçi pati dhënë zotimin e qeverisë së tij se “Task Forca Anti-Korrupsion do të gëzojë gjithë mbështetjen politike pa asnjë ndërhyrje politike”. Më tutje, ai pati pohuar se “Task Forca Anti-korrupsion ka për detyrë që në mënyrë specifike të luftojë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, ndërkaq shqyrtimi i rasteve të rëndomta të korrupsionit u takon prokurorëve komunalë dhe atyre të qarkut. Kjo nënkupton që prokurorët e Kosovës, dhe jo ata të EULEX-it, e kanë për detyrë kryesore të ballafaqohen me krime të tilla”.¹⁵

Duke themeluar një mekanizëm të tillë, dhe duke e përvetësuar atë si meritë dhe kontribut të drejtpërdrejt të saj, qeveria ka synuar ta krijojë përshtypjen se ajo njëmend është e përkushtuar në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Megjithatë, tre vjet më pas (prej themelimit të saj) TFA jo vetëm që nuk ka ndikuar në luftimin e aferave të zyrtarëve të lartë publikë, por për më tepër vetë shefi i saj është duke u akuzuar për vepra korruptive.

Ndër dobësitë kryesore që kanë shoqëruar një mekanizëm të tillë janë:

- g. mungesa e analizave dhe studimeve paraprake që do të arsyetonin themelimin e një mekanizmi të tillë në luftë kundër korrupsionit;
- h. emërtimet e llojllojshme dhe paqartësitë e tjera mbi karakterin e këtij mekanizmi;
- i. përbërja e përzier e prokurorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë (moskoordinimi dhe mos-lejimi i prokurorëve vendorë në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë më nivelin e lartë të zyrtarëve publikë);
- j. korniza e pa definuar e fushëveprimit ligjor dhe funksionimi përbrenda PSRK-së;
- k. Profil i ulët i zyrtarëve të akuzuar për vepra korruptive; si dhe
- l. mungesa e transparencës dhe mos-bërja publike e punës së tyre në luftë kundër korrupsionit.

¹³ Përveç këtyre vendimeve, përgjatë viteve 2010 dhe 2011 Qeveria ka miratuar edhe një sërë vendimesh në luftë kundër korrupsionit. Në kuadër të këtyre vendimeve hyjnë shkarkimi i zv. ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, inicimi i nxjerrjes së projekt-ligjit për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, si dhe ka përkrahur kërkesën e Prokurorisë Speciale për stimuli financiar për prokurorë dhe personelin tjetër punonjës.

¹⁴ Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë. Prill 23, 2010. <http://www.eulex-kosovo.eu/al/news/000218.php> (i qasur me 7 Qershor, 2012).

¹⁵ Po aty.

4.1. Mungesa e analizave dhe studimeve paraprake

Megjithëse iniciativa për të themeluar Task-Forcën Anti-Korrupsion është dashur të bazohet në analiza dhe studime paraprake, qeveria e Kosovës nuk e ka parë të udhës një gjë të tillë. Sipas hulumtuesit të Organizatës ÇOHU!, Lorik Bajrami, “themelimit të këtij mekanizmi është dashur t’i paraprijnë analiza, hulumtime dhe studime paraprake që do të shqyrtonin nëse vendi ynë ka nevojë për krijimin e mekanizmave të rinj në luftë kundër korrupsionit”.¹⁶ Sipas tij, “institucionet e Republikës së Kosovës asnjëherë nuk kanë themeluar mekanizma që do t’u përgjigjeshin situatës në terren, por themelimi i tyre ka ardhur si pasojë e presionit të jashtëm” (ibid). Të njëjtin mendim shfaqë edhe hulumtuesi tjetër nga Instituti i Kosovës për Drejtësi,

“Institucionet e Republikës së Kosovës asnjëherë nuk kanë themeluar mekanizma që do t’i përgjigjeshin situatës në terren”.

(Lorik Bajrami, hulumtues në ÇOHU!)

Adem Gashi, i cili pohon se “themelimi i Task-Forcës ka qenë iniciativë ad hoc; pa ndonjë analizë të mirëfilltë paraprake”.¹⁷ Sipas tij, “qeveria e Kosovës asnjë vendim të saj nuk e ka marrë duke u bazuar në hulumtime apo studime përkatëse, por secili vendim i saj ka ardhur si rezultat i presionit të brendshëm: për ta krijuar përshtypjen tek qytetarët se qeveria po e lufton korrupsionin, si dhe presionit të jashtëm: për ta krijuar bindjen tek mekanizmat relevantë ndërkombëtarë se qeveria është e përkushtuar në luftimin e korrupsionit”. Më tutje, ai shton se “qeveria në cdo kohë e merr lavdin për Task-Forcën Anti-Korrupsion, ndërkaq me rastin e ngjarjes së ‘çështjes Mustafi’ ajo përnjëherësh heq dorë nga ajo duke e distancuar veten nga çfarëdolloj përgjegjësie që mund të ketë”. Sipas tij, “qeveria e ka themeluar një mekanizëm të tillë me qëllim që ta dështojë tërë sistemin e drejtësisë” (ibid).

4.2. Emërtimet e llojlojshme për Task-Forcën Anti-Korrupsion

Asnjë mekanizëm tjetër në luftë kundër korrupsionit nuk është emërtuar në mënyra më të ndryshme sesa Task-Forca Anti-Korrupsion. Derisa në vendimin e qeverisë emërtohet si ‘Departament Special Anti-Korrupsion’, në diskursin publik është njohur kryesisht si Task-Forcë Anti-Korrupsion. Ndërkaq Bashkimi Evropian (në Raportin e Fizibilitetit) e emërton si Task-Forcë e Posaçme Hulamtuese. Mirëpo sipas prokurorit Faik Halimi, i cili punon në TFA prej themelimit të saj, “emërtimet Task Forcë apo Departament Special Anti-Korrupsion

Emërtimet e ndryshme:

- a. *Departament Special Anti-Korrupsion (qeveria)*
- b. *Task-Forcë Anti-Korrupsion (shoqëria civile)*
- c. *Sektor i Luftimit të Krimit Financiar (PSRK)*
- d. *Task-Forcë e Posaçme Hulamtuese (Raporti i Fizibilitetit)*

¹⁶ Bajrami, Lorik, intervistuar nga Armend Mazreku. (08 07, 2012).

¹⁷ Gashi, Adem, intervistuar nga Armend Mazreku. (09 07, 2012).

nuk i shkojnë përshtati punës që ajo bën. Emërtimi më adekuat është Sektor i Luftimit të Krimet Financiar”.¹⁸ Emërtimet e tilla të llojllojshme kanë bërë që Task-Forca nga një mekanizëm në luftë kundër korrupsionit të rrëshqasë në “një mekanizëm për luftimin e krimeve financiare” (Halimi, 2012), si dhe fushëveprimi i saj të bëhet edhe më i errët e i paqartë sa i përket luftimit të aferave korruptive.

4.3. Përbërja e përzier e prokurorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë

Task-Forca Antikorrupsion, e cila vepron përbrenda Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, përbëhet nga gjithsej 8 prokurorë: 5 vendorë dhe 3 të tjerë nga radhët e EULEX-it.¹⁹ Përveç këtyre prokurorëve, në kuadër të saj veprojnë edhe 30 (tridhjetë) oficerë hetues të Policisë së Kosovës, të cilët janë të angazhuar drejtpërdrejt në hetimin e rasteve që hetohen nga Departamenti Special Anti-Korrupsion. Pjesë e kësaj Task-Force janë edhe 5 (pesë) ekspertë, të cilët kanë përgatitje dhe përvojë të mjaftueshme në fushën e tatimeve dhe çështjeve tjera në luftimin e dukurive negative. Këta pesë ekspertë

punojnë ekskluzivisht vetëm në çështje të cilat janë në kompetencë të TFA. Kjo përzierje e prokurorëve vendorë me ata ndërkombëtarë ka bërë që prokurorët e vendit të merren me shqyrtimin e lëndëve të profilit të ulët të zyrtarëve publikë, ndërkaq ata të EULEX-it të merren me rastet e profilit të lartë. Një profilizim i tillë është në

Profili i zyrtarëve që hetohen dhe persekutohen nga Task-Forca:

- *Profili i lartë (të përfshirë vetëm prokurorët e EULEX-it)*
- *Profili i mesëm (prokurorë vendorë dhe të EULEX-it)*
- *Profili i ulët (të përfshirë vetëm prokurorët vendorë)*

kundërshtim edhe me vetë deklaratimet e kryeministrit Thaçi, sipas të cilit “Task Forca Anti-korrupsion ka për detyrë që në mënyrë specifike të luftojë rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, ndërkaq shqyrtimi i rasteve të rëndomta të korrupsionit u takon prokurorëve komunalë dhe atyre të qarkut. Kjo nënkupton që prokurorët e Kosovës, dhe jo ata të EULEX-it, e kanë për detyrë kryesore të ballafaqohen me krime të tilla”.²⁰ Pra, në vend që prokurorët vendorë të punojnë në rastet e profilit të lartë ata punojnë kryesisht në lëndët që kanë të bëjnë me zyrtarë të profilit të ulët, e të cilat lëndë normalisht do të duhej të shqyrtoheshin nga prokurorë komunalë dhe/ose të qarkut. Ndonëse një situatë të tillë e pranon edhe vetë (u.d.) shefja e Task-Forcës Sevdije Morina, ajo prapëseprapë pohon se “s’ka asnjë arsye pse prokurorët vendorë të mos përfshihen në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë politik”.²¹ Përveç kësaj, prokurorëve vendorë u mungon edhe informacioni në lidhje me lëndët që shqyrtohen nga kolegët e tyre prokurorë ndërkombëtarë, duke qenë se mungon koordinimi dhe komunikimi në mes tyre. Sipas

¹⁸ Halimi, Faik, intervistuar nga Nora Bajrami dhe Armend Mazreku. (08 29, 2012).

¹⁹ “Ndonëse Nazmi Mustafa në media është kuptuar si udhëheqës i Task Forcës Anti-Korrupsion, zyrtarisht nuk ka qenë asnjëherë. Ai ka qenë udhëheqës “nën hije”, që në rast se shkojnë ndërkombëtarët ai të jetë veç i përgatitur për ta udhëhequr këtë pozitë, por asnjëherë s’ka qenë shef i TFA-së” (Faik Halimi).

²⁰ Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë. Prill 23, 2010. <http://www.eulex-kosovo.eu/al/news/000218.php> (i qasur me 7 Qershor, 2012).

²¹ Morina, Sevdije, intervistuar nga Nora Bajrami dhe Armend Mazreku. (08 29, 2012).

Gashit, "ndërkombëtarët mund të asistojnë dhe vendorët ta marrin barrën e sistemit, në të kundërtën dështojnë" (Gashi, 2012).

4.4. Korniza e paqartë ligjore e funksionimit të Task-Forcës

Rregullativa ligjore e Task-Forcës përbëhet nga Ligji për Prokurorinë Speciale dhe Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Kompetencat e veta ligjore në fushën e luftës kundër korrupsion TFA i realizon sipas Kreut III - Kompetencat Plotësuese të Ligjit për PSRK-në (bazuar në veprat penale me natyrë korruptive sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës). Në kuadër të këtyre kompetencave hyjnë:

- lidhja e kontratave të dëmshme (neni 237, KPPK);
- pranimi i paarsyeshëm i dhuratave (neni 250, KPPK);
- dhënia e paarsyeshme e dhuratave (neni 251, KPPK);
- shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339, KPPK), pranimi i ryshfetit (neni 343, KPPK);
- dhënia e ryshfetit (neni 344, KPPK);
- përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës (neni 340, KPPK).

Mirëpo, sipas nenit 10 të këtij Ligji specifikohet se "PSRK-ja do të ushtrojë kompetencën e vet plotësuese lidhur me veprat penale të paraqitura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji (...) në qoftë se njëri nga kriteret e mëposhtme të jetë plotësuar:

a) është e arsyeshme të besohet se sjellja e supozuar kriminale është pjesë e një fenomeni kriminal serioz që ndodhë ose ka ndodhur në vende të ndryshme të Kosovës dhe që mund të jetë në kompetencë territoriale të gjykatave të ndryshme sipas ligjit në fuqi, me qëllim që të garantohet një bashkërendim unik i hetimit a ndjekjes penale;

b) është e arsyeshme të besohet se sjellja e supozuar kriminale është pjesë e një aktiviteti kriminal më të gjerë tej kombëtar që bën të nevojshëm bashkëpunimin ndërkombëtar për të arritur një hetim a ndjekje tërësore të krimit;

c) ekziston dyshimi i bazuar lidhur më përpjekjet e paligjshme për të ndikuar në hetimin ose ndjekjen e sjelljes së supozuar kriminale;

d) sjellja e supozuar kriminale rrezikon ose ka rrezikuar funksionimin e stabilitetit të shtetit ose të organeve të tij, apo funksionimin e stabilitetit të institucioneve publike ose të organeve të tyre që veprojnë në Kosovë;

e) ekziston dyshimi i bazuar se PSRK-ja, për shkak të rrethanave të veçanta, ose të komplikimit, a të natyrës së sjelljes së supozuar kriminale, është organi i vetëm që mund të realizojë një hetim ose ndjekje tërësore të krimit.²²

Sipas Koordinatorës së Prokurorëve në Luftë Kundër Korrupsionit, Drita Hajdari, "Task-Forca s'është dashur të jetë në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pasi që të 11 veprat penale me natyrë korruptive hyjnë në kuadër të prokurorive komunale dhe atyre të qarkut".²³ Më tej ajo shton se "me LPS Task-Forca gëzon vetëm kompetenca

²² Ligji për Prokurorinë Speciale, Kuvendi i Kosovës, http://psh-ks.net/repository/docs/T-Ligji_per_Prokurorine_Speciale_te_Republikes_se_Kosoves-shqip_i_lekturuar_me_07.05.pdf.

²³ Hajdari, Drita, intervistuar nga Nora Bajrami dhe Armend Mazreku. (05.23, 2012).

plotësuese sa i përket luftimit të korrupsionit, e jo kompetenca ekskluzive siç do të duhej të kishte” (ibid). Në linjë të njëjtë është edhe vetë prokurori i kësaj Task-Force, Faik Halimi, i cili e pranon se “TFA e realizon fushëveprimin e vet bazuar në “kompetencat plotësuese ose subsidiare të Ligjit për Prokurorinë Speciale” (Halimi, 2012). Derisa një mekanizëm i tillë është menduar pra të jetë i specializuar për hetimin e veprave penale me natyrë korruptive, funksionimi i tij përbrenda Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e ka pamundësuar përmbushjen e misionit për të cilin është krijuar - luftimi i rasteve të rënda të korrupsionit. Madje, shumica e rasteve të hetuara nga Task-Forca (shih më poshtë pikën 4.5) nuk e plotësojnë asnjërin prej kushteve të përcaktuara me nenin 10 të Ligjit për PSRK-në.

4.5. Profili i ulët i zyrtarëve publikë të akuzuar për vepra korruptive

Niveli i zyrtarëve publikë të përfshirë në hetime nga Task-Forca Anti-Korrupsion është larg pritshmërisë të qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mekanizmave ndërkombëtarë. Nëse marrim vetëm disa nga akt-akuzat (më të rëndësishme të Task-Forcës), të cilat janë ngritur në kohëra të ndryshme, shohim se niveli i zyrtarëve është shumë i ulët:

- Aktakuzë kundër 4 (katër) të pandehurve: Kolë Puka (ish-gjyqtar - tani avokat); Lon Palushaj (avokat); Bedri Bakalli (ortoped-traumatolog) dhe Isa Salihi (përfaqësues i Fondit të Garancisë së Kosovës në Prishtinë)²⁴;
- Aktakuzë kundër 10 avokatëve: Sadik Tanyol nga Prizreni, Shefqet Ibrahim nga Skenderaj, Prenk Pepaj nga Gjakova, Mustafë Musa nga Gjilani, Xhafer Maloku nga Klina, Fahire Qeko Kabashi nga Prizreni, Muharrem Ramadani nga Mitrovia, Xhavit Krreku nga Gjakova dhe Haxhe Nikqi nga Peja²⁵; si dhe
- Aktakuzë kundër 20 personave (Fatos Salihaj, Astrit Dema, Ranadan Myrtar, Mustafë Murselaj, Bislam Haklaj, Arif Lokaj, Arben Sadija, Nexhat Idrizi, Fitim Ramadani, Agim Spahiu, Avdullah Gjajkocaj, Ardian Koci, Shukrije Bekteshi, Shaqë Fetaj, Islam Duqi, Lavdi Avllaj, Bali Mahmuti, Afërdita Berishën, Isak Gjinovcin dhe Mehmet Duqin)²⁶.

Ndërkaq si raste të profilit të lartë mund të llogariten aktakuzat e ngritura ndaj:

²⁴ Aktakuza ka të bëjë me veprën penale “Krim i Organizuar” nga neni 274 i Kodit Penal të Kosovës, lidhur me veprat penale “Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit” nga neni 339 par. 1 lidhur me par 3. dhe “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” nga neni 346 i KPK-së. Ndërkaq, ndaj të pandehurve Kolë Puka dhe Lon Palushaj aktakuza ka të bëjë edhe për një vepër të posaçme penale “Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve” nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin paragrafi 1, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Me gjerësisht shih <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,154>.

²⁵ Të pandehurit akuzohen pasi që nga viti 2003 e këndeje, duke përfaqësuar klientët e tyre, disa me autorizim e disa pa autorizim, pas përfundimit të procedurës lidhur me kompensimin e dëmit pranë kompanisë së sigurimit “Kosova në Likuidim” në Prishtinë, të njëjtës i kanë sugjeruar që mjetet financiare t’i transferonin në llogaritë e avokatëve e jo të klientëve. Avokatet e pandehur në shumë raste kanë falsifikuar autorizimet në emër të klientëve të tyre.

²⁶ Të gjithë personat në fjalë janë akuzuar për “shpërdorim të detyrës zyrtare” dhe “përvetësim gjatë ushtrimit të funksionit publik”. Me hollësisht shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,181>.

Hulumtim Politikash: Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit

- Zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH): Bujar Bukoshi, Ilir Tolaj, Arbenita Pajaziti, Nexhat Shabani, Ismet Hysenit, Hajrullah Fejzën, Zenel Kuqin, Bekim Fushën, Alban Thaçin, Basri Asllanin dhe Imer Ajetinin²⁷; si dhe
- Zyrtarëve të PTK-së: Leme Xhemen dhe Ove Johansen (menaxher i Norway Invest R&O AS), Shyqri Haxha - drejtor i PTK-së dhe Rexhë Gjonbalaj - Kryesues i Bordit të Drejtorëve të PTK-së (Lidhja e Kontratave të Dëmshme, Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare dhe Keqpërdorim i Autorizimeve në Ekonomi); Ismet Bojku - përfaqësues ligjor i Dardafon dhe Dardafon.net, dhe Shkëlqim DEVOLLI e Blerim DEVOLLI, pronarë të kompanive private që i përkasin DEVOLLI GROUP (Mashttrim, Lidhja e Kontratave të Dëmshme, Keqpërdorim i Besimit, Falsifikimi i Dokumenteve, Rastet e Posaçme të Falsifikimit të Dokumenteve, dhe Krim të Organizuar).²⁸

Mirëpo në dy prej rasteve më të mëdha, ai i ish Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe ai i ish-gubernatorit Hashim Rexhepi, Task-Forca ka dështuar plotësisht. Akuzat kundër tyre në fillim ishin shumë të rënda, për t'u reduktuar pastaj në disa e në fund (në rastin e Hashim Rexhepit) i akuzuari është shpallur i pafajshëm²⁹. Një rast tjetër i nivelit të lartë është edhe ai i drejtorit të Doganave të Kosovës, Naim Huruglica dhe ish-drejtor në Departamentin Ligjore të DK, Lulzim Rafuna, të cilët më pas janë shpallur të pafajshëm nga trupi gjyqësor i përbërë nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjykatës vendor.³⁰

Po ta krahasojmë po ashtu nivelin e aktakuzave të ngritura nga Task-Forca me atë të Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë shohim se kjo e fundit ka përfshirë nivel më të lartë politik:

- Aktakuzë kundër ish ministrave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Astrit Haraqija³¹ dhe Valton Beqiri³²;
- Aktakuzë kundër Ekrem Rexha, Ridvan Shahini, Refik Sadiku, Halil Fejziu, Qazim Bajrami dhe Hazir Krasniqi (të gjithë zyrtarë të Komunës së Prishtinës)³³;

²⁷ Akuzat që rëndojnë mbi ta kanë të bëjnë me shpërdorim të detyrës zyrtare e autorizimit, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave, keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi, lidhje të kontratës së dëmshme, nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, marrje ryshfeti dhe shmangie nga tatimi. Me gjerësisht shih Gazeta JnK. 09 20, 2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3244> (i qasur me 8 Tetor, 2012).

²⁸ Aktakuza kundër pesë të pandehurve është ngritur në kontekstin e një hetimi në lidhje me marrëveshjen për Operatorin e Rrjetit Mobil Virtual në mes të PTK-së dhe Dardafon dhe transferimin e mëvonshëm të licencës për Dardafon.net në vitin 2008 dhe 2009. Koha.net. Qershor 8, 2011. <http://www.kohaditore.com/index.php?page=1,13,58030> (i qasur me 14 Korrik, 2012).

²⁹ Preportr. 10 04, 2012. <http://preportr.com/sq/Siguri-dhe-Gjyqesi/Lufta-kundr-korrupsionit-me-televizor-211> (i qasur me 10 09, 2012).

³⁰ www.kosovaitimes.net. 05 17, 2012. <http://www.kosovaitimes.net/?page=1,17,6659> (qasur me 08 18, 2012).

³¹ Sipas aktakuzës i pandehuri Astrit Haraqija, në kohën kur e ushtronte funksionin e ministrit, ka kryer dy vepra penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës. Vepra e parë ka të bëjë me lidhje të kundërligjshme të kontratës me kompaninë "Concordia Pictures", me ç'rast i pandehuri Haraqija, duke keqpërdorur pozitën zyrtare dhe duke tejkaluar autorizimet, ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerë prej 188.000,00€. Ndërkaq, vepra e dytë penale ka të bëjë gjithashtu me lidhje të kundërligjshme të kontratës me kompaninë "Morina Films", me ç'rast i pandehuri Haraqija, sërish duke keqpërdorur pozitën zyrtare dhe duke tejkaluar autorizimet ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerë prej 100.000,00€.

³² Sipas aktakuzës i pandehuri Valton Beqiri ngarkohet për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par.1 të KPK-së. i pandehuri në kohën derisa ushtronte funksionin e ministrit, ka keqpërdorur pozitën zyrtare, duke tejkaluar autorizimet edhe pse ka pasur dijeni se kontrata që kishte lidhur ministri i mëparshëm Haraqija, ishte e kundërligjshme, ka lidhur aneks kontratën me kompaninë "Morina Films", duke dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerë prej 100.000,00€.

- Aktakuzë kundër kryetarit të Drenasit Nexhat Demaku³⁴
- Aktakuzë kundër zyrtares së prokurimit në Policinë e Kosovës, Xhevahire Potovci³⁵, si dhe një numër akuzash tjera në prokuroritë e tjera të qarkut dhe ato komunale.

Duke parë një situatë të tillë, ku Task-Forca shqyrton lëndë të profilit të ulët politik, të cilat edhe bien në domenin e prokurorive komunale apo të qarkut, kryeprokurori ka nxjerrë një udhëzim administrativ, me të cilin kërkohet nga "Policia e Kosovë që t'i njoftojë dhe t'u dorëzojë prokurorive të qarkut apo komunale, varësisht nga kompetenca e tyre lëndore, çdo raport fillestar, informatë paraprake apo kallëzim penal - pa marrë parasysh se kryesit janë të njohur apo të panjohur për të gjitha veprat penale nga neni 9 i Ligjit për PSRK-në, me të cilin parashihen veprat penale që janë në kompetencë plotësuese të asaj prokurorie". Më tutje është kërkuar që "të gjitha raportet fillestare, informatat paraprake apo edhe kallëzimet penale që para kësaj dite i janë dërguar PSRK-së dhe kanë të bëjnë me kompetencën e saj plotësuese, menjëherë duhet t'u dërgohen nga një kopje e tyre edhe prokurorive të qarkut apo komunale varësisht nga kompetencat e tyre territoriale dhe lëndore".³⁶

4.6. Mungesa e transparencës së (mos)punës së Task-Forcës

Asnjë institucion tjetër në luftë kundër korrupsionit nuk është treguar më i mbyllur për opinionin publik sesa Task-Forca Anti-Korrupsion. Prej themelimit të saj në vitin 2010 e deri më tani as edhe një raport i vetëm nuk është bërë i ditur për publikun. Nëse kërkohen ta zëmë statistikat sesi ka përfomuar ky institucion në luftë kundër korrupsionit, prokurorët vendorë të obligojnë t'i detyrohesh zyrtarëve të EULEX-it, ndërkaq këta të fundit të përgjigjen: 'pyetjet janë tejet politike' ose 'dëmtojnë procesin e hetimeve'. Madje, politike cilësohen edhe pyetjet si: "sa prokurorë të EULEX-it punojnë në Task-Forcë"?, "sa aktakuza gjithsej ka ngritur TFA prej themelimit të saj"?, "sa është vlera buxhetore e shpëtuar nga Task-Forca"?, etj.³⁷ Sipas Bajramit, "mungon llogaridhënia e sistemit në përgjithësi dhe e Task-Forcës në veçanti" (Bajrami, 2012). Të njëjtin qëndrim mban edhe hulumtuesi Gashi, i cili pohon se "Task-Forca me qëllim është mbyllur për

³³ Gjashtë të pandehurit, sipas Kontratës për ndërtimin e kolektorit atmosferik mbi lumin "Prishtina", në lagjen Kalabria në Prishtinë, me qëllim të përfitimt të kundërligjshëm për ndërmarrjen private "Çlirimi" nga Korisha-Prizren, duke tejkalluar autorizimet e tyre zyrtare, kryesit e punëve i paguan apo urdhëruan t'i paguhen 846.712.80 euro në emër të materialit të blerë edhe pse kjo nuk ishte paraparë me kontratë dhe ishte në kundërshtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik. Prokurori i Shtetit. 06 26, 2011. <http://psh-ks.net/?page=1,8,147> (qasur me 09 13, 2012).

³⁴ Kryetari i Drenasit, Nexhat Demaku (1976), që është anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës, akuzohet se ka kryer këtë vepër penale, duke mos respektuar vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilat e detyronin që t'ia njihnte drejtën pronësore të një toke në Drenas familjes Hasi. Të akuzuar bashkë me të janë edhe drejtori i Kadastrës, Mehdi Kurrumeli (1960), dhe referenti në Drejtorinë e Kadastrës, Shefqet Morina (1958). Koha.net. Qershor 8, 2011. <http://www.kohaditore.com/index.php?page=1,13,58030> (accessed Korrik 14, 2012).

³⁵ E pandehura Xhevahire Vatoci, person zyrtar në Policinë e Kosovës, në Prishtinë, me qëllim të përfitimt të kundërligjshëm, për ndërmarrjen private "HIB Petrol" SH.P.K. nga Ferizaj, në cilësinë e zyrtarit të zyrës së prokurimit dhe kryetares së komisionit për vlerësim, ka shpërdoruar pozitën zyrtare dhe ka tejkalluar autorizimet zyrtare, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë, që si pasojë ka rezultuar me përfitimt kundërligjor për ndërmarrjen private "HIB Petrol" në shumë prej 280.370,91€, shumë kjo me të cilën ka dëmtuar buxhetin e Policisë së Kosovës. Prokurori i Shtetit. 10 25, 2011. <http://psh-ks.net/?page=1,8,172> (qasur me 07 12, 2012).

³⁶ Kjo e kërkesë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është bërë me 15 Gusht 2011.

³⁷ Përveç që nuk janë përgjigjur me kohë sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, nuk kanë ofruar as edhe një përgjigje të vetme në pyetjet e parashtruara. Sipas shëfës së PSRK, Signe Justesen, "pyetjet e tilla janë politike dhe rrezikojnë procesin e hetimeve që po zhvillohen". Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Ref.: SPRK/lett/LV/170/2012. 28 Shtator, 2012

publikun në mënyrë që ta fshehë dështimin e vet” (Gashi, 2012). Përveç që mungon transparenca në relacion me qytetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, ajo mungon edhe në relacion me institucionet. Sipas koordinatorës Hajdari, “mungon komunikimi dhe raportimi i Task-Forcës Anti-Korrupsion me Zyrën e Prokurorit të Shtetit” (Hajdari, 2012). Madje, nga intervistat që kemi zhvilluar rezulton se mungon transparenca edhe përbrenda vetë këtij institucioni, ku prokurorët vendorë nuk e dinë saktësisht se në cilat lëndë punojnë prokurorët e EULEX-it dhe procesin e shqyrtimit të tyre.

Të gjitha këto dobësi që hulumtimi identifikon kanë bërë që Task-Forca Anti-Korrupsion të mos e përmbush misionin e saj për luftimin e korrupsionit, por të krijojë edhe më shumë paqartësi në lidhje me atë se cili institucion është përgjegjës për luftimin e nivelit të lartë politik në Kosovë.

5. Vendimi i Dytë: Agjencia Për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar

Konfiskimi i aseteve të fituara nëpërmjet kryerjes së veprave penale është vegël e shkëlqyeshme për sanksionimin e kriminelëve dhe njëkohësisht për kompensim nga shteti të dëmeve të krijuara. Në çdo krim ekziston një palë e dëmtuar ose viktimë që mund të jetë/individ ose subjekt juridik. Prandaj, shoqëria si tërësi ka interes të madh në konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga kriminelë të dyshuar apo të dënuar, në mënyrë që të kompensojë dëmet e shkaktuara. Përfituesit e konfiskimit nuk kufizohen vetëm në viktimat e drejtpërdrejta. Këta më shumë mund të jenë grupe të marginalizuara apo grupe që i shërbejnë interesit publik, që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara, të varfrit, madje edhe organizata të shoqërisë civile që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve për shtetin ose janë drejtpërsëdrejti të përfshira në luftën kundër aktiviteteve kriminale.³⁸Në shkurt të vitit 2010 Qeveria pati nxjerrë vendim për të rritur buxhetin dhe numrin e stafit (17 pozita) për Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar. Në këtë vendim thuhet se “janë krijuar parakushte dhe rekuizita më të favorshme për ngritjen e cilësisë dhe eficensën e punës së këtij institucioni”.³⁹ Sipas statistikave rezulton se rritja e numrit të stafit ka ndikuar që ndër vite të rritet edhe vlera e pasurive të administruara nga Agjencia. Derisa në vitin 2010 vlera e pasurive ka qenë vetëm 1,720.00 Euro, në vitin 2011 73,882.00 Euro, në vitin e fundit ajo është rritur në mënyrë të shumëfishtë: 1,100,000.00 Euro. Megjithatë, shikuar nga aspekti cilësor nuk është se Agjencia

Llojet e pasurive të administruara:

- Kafshë
- Mjete të transportit
- Pajisje TI
- Para cash, etj.

³⁸ KIPRED. Prill 2011. [http://www.kipred.org/advCms/documents/52145_Konfiskimi_i_pasurive%20\(1\).pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/52145_Konfiskimi_i_pasurive%20(1).pdf) (qasur me 09 23, 2012).

³⁹ Qeveria e Kosovës. 03 08, 2010.http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_113-te_te_Qeverise_2010.pdf (qasur me 05 09, 2010).

Hulumtim Politikash: Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit

për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar ose të Sekuestruar ka shënuar lëvizje progresive. Shumica e pasurive të saj që administrohen përbëhen nga kafshë (lopë, kuaj, vica), mjete të transportit (kamionë, vetura), pajisje TI, para cash, etj.⁴⁰



Këtu qëndron edhe dobësia kryesore e kësaj Agjencie, e cila vazhdon të mos jetë e specializuar në fushën e korrupsionit, shpëlarjes së parasë dhe krimit të organizuar. Në vend që qeveria, përkatësisht Ministria e Drejtësisë (MD), ta shndërronte më herët në prioritet specializimin e saj, ajo e ka vendosur atë vetëm në vitin 2012. Në dokumentin e kësaj ministrie specifikohet se “do të bëjë profilizimi i Agjencisë që të administrojë pasuritë e sekuestruara ose të konfiskuara të pajustificueshme që rrjedhin kryesisht nga veprat penale të krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.⁴¹

Dobësi tjetër e radhës kësaj Agjencie është se dënimet e mëdha nuk kanë çuar njëkohësisht edhe në konfiskim të pasurive. I këtillë është rasti i Qamil Shabanit nga Ferizaj. Prej nëntorit të vitit 2009, Gjykata Supreme kishte konfirmuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut me të cilin Shabani ishte dënuar me

15 vjet burgim dhe 100 mijë euro gjobë për prodhimin e paautorizuar të narkotikëve. Gjoha nuk është ekzekutuar asnjëherë megjithëse kanë kaluar gati tri vjet. Shabani së bashku me 8 persona të tjerë ishin akuzuar për trafikimin e rreth 130 kg heroine nëpër vende të Evropës. Aktgjykimi ishte konfirmuar edhe në shkallën e tretë dhe sipas avokatit të tij, Fazli Balaj, Shabani tashmë po vuan dënimin në burg por mjetet nuk do t'i paguajë (Gazeta JnK, 2012).

Dhe dobësia tjetër e radhës ka të bëjë me mungesën e komunikimit në mes të Agjencisë dhe institucionet tjera relevante. Sipas shefit të

kësaj Agjencie, Rrahim Rama, “sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial nuk janë të mirinformuar që gjësendet e konfiskuara dhe/ose të sekuestruara duhet të raportohen tek



⁴⁰ Gazeta JnK. Maj 21, 2012. <http://www.gazetajn.com/repository/docs/RAPORTI.pdf> (qasur me 10 07, 2012).

⁴¹ Ministria e Drejtësisë. Janar 2012. http://www.md-ks.org/repository/docs/Prioritetet_e_MD_per_vitin_2012_-_Konf_per_shtyp_17_01_12.pdf (qasur me 09 03, 2012).

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar”.⁴² Sipas statistikave të kësaj Agjencie, deri në prill të vitit 2012 numri i vendimeve për konfiskim dhe/ose sekuestrim është 34. Numri më i madh i tyre (21 vendime) është nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale 7 sosh, nga gjykatat 6 dhe nga prokuroritë vetëm 1 vendim. Ndërkaq shumica e këtyre vendimeve (19) kanë qenë të vitit 2012, 11 të vitit 2011 dhe vetëm 2 vendime në vitin 2010.

6. Vendimi i Tretë - Ndryshimi i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë

Dy muaj para se Raporti i Progresit (2011) të publikohej nga Komisioni Evropian, Qeveria e Kosovës pati marrë vendim⁴³ për ta ndryshuar pjesërisht kornizën ligjore në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit. Njëri ndër ligjet që duhej të ndryshohej asokohe ishte edhe ligji i lartpërmendur, ani pse vetëm një vjet më parë ishte miratuar. Ky ligj “përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, detyrën e Agjencisë Kundër Korrupsion për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre”.⁴⁴

Mirëpo me gjithë ndryshimet e bëra, përmbajtja substanciale e këtij ligji mbetet edhe më tutje e njëjtë. Ndryshimet e vetme që janë bërë janë në kuadër të Kreut VI - Dispozitat Ndëshkimore. Derisa në ligjin paraprak shuma ndëshkimore për mos-deklarim ka qenë prej 150.00 - 1000.00 Euro, në ligjin e tanishëm aplikativ shuma sanksionuese është përcaktuar të jetë prej 1000.00 - 2500.00 Euro. Megjithatë, shuma e tillë e përcaktuar mbetet edhe më tutje e vogël, e cila shumë është kritikuar edhe në Raportin e Fizibilitetit të Bashkimit Evropian. Krahas shumë në mjete financiare, ligji përcakton edhe “ndalimin e ushtrimit të funksionit publik deri në një vit” (ibid). Megjithatë, masat e tilla ndëshkimore janë tejet të vogla krahasuar me ato të vendeve në rajon e mos të flasim për praktikën dhe standardet ndërkombëtare.

Problemi kryesor i këtij ligji nuk është tek deklarimi i pasurisë, por tek prejardhja e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, si dhe pamundësia për ta kontrolluar origjinën e saj. Megjithëse ligji në fuqi e obligon Agjencinë Kundër Korrupsion të bëjë “kontrollin për saktësinë e deklarimeve të pasurive”⁴⁵, ajo një gjë të tillë nuk e ka bërë as edhe një herë të vetme. P.sh. nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë për vitin 2011, 1483 zyrtarë të lartë publik e kanë përmbushur obligimin ligjor, ndërsa vetëm 77 zyrtarë të lartë publik nuk kanë respektuar një detyrim të tillë. Megjithatë, të 77 zyrtarët që nuk e kanë deklaruar pasurinë nuk përbëjnë nivelin më të lartë politik në vend dhe shuma më e lartë e shqiptuar

⁴² Rama, Rrahim. intervistuar nga Nora Bajrami dhe Armend Mazreku. (09 07, 2012).

⁴³ Qeveria e Kosovës. 07 13, 2011. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_23-te_te_Qeverise_2011.pdf (qasur me 08 17, 2012).

⁴⁴ Kuvendi i Kosovës. 08 31, 2011. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20deklarimin%20e%20pasurise%20se%20zyrtarve%20te%20larte.pdf> (qasur me 09 15, 2012).

⁴⁵ Ibid.

sanksionuese ndaj tyre nuk e kapërcen shifrën prej 1000.00 Euro.⁴⁶ Andaj, ndryshimi i këtij ligji nuk ka ndryshuar aspak substancën e ligjit paraprak, por vetëm anën e pandikueshme të saj - shifrën monetare të ndëshkueshmërisë së zyrtarëve që nuk e bëjnë deklarin e pasurisë së tyre.

7. Vendimi i Katërt: Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Informatorëve (LMI)

Parandalimi i korrupsionit në të gjitha nivelet e institucioneve është çelësi kryesor i një politike anti-korrupsion. Ndikim shumë të madh në këtë drejtim kanë posaçërisht zyrtarët që punojnë në institucionet publike. Duke qenë se të gjitha vendet në rajon e rregullojnë një fushë të tillë, të mbrojtjes së raportuesve të korrupsionit që janë në funksione publike, në korrik të vitit 2011 Qeveria e Kosovës pati miratuar vendimin për Projekt-ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve⁴⁷, i cili projekt-ligj një muaj më pas është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Megjithëse shënon një lëvizje pozitive miratimi i tij, dobësitë e shumta që e shoqërojnë këtë ligj bëjnë që zyrtarët edhe më tutje të mos raportojnë për rastet korruptive që ata hasin në institucionet e tyre përkatëse.

Mangësia fillestare e këtij ligji ka të bëjë me vetë emërtimin e tij. Në vend që të quhej Ligji për Mbrojtjen e Zyrtarëve që Raportojnë Korrupsionin, ligji është emërtuar 'Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve'. Sipas përkufizimit të këtij ligji, "informator është çdo person, i cili si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor".⁴⁸ Duke marrë parasysh se 'informatori' ndërlidhet kryesisht në shërbime të ndryshme inteligjente/sekrete, ndikon që zyrtarët e ndryshëm institucionalë, në rastet kur ata vërejnë praktika të dyshimta abuzive, do të ngurrojnë t'i raportojnë ato duke e parë (pa dashje) vetveten si 'informator' apo 'spion'.

Së dyti, ligji në fjalë nuk përcakton ndonjë institucion apo komision të posaçëm në të cilin do të mund të raportoheshin praktikat e dyshimta abuzive nga ana e zyrtarëve institucionalë. Sipas këtij ligji, "informatorët të cilët dyshojnë për veprimet kundërligjore duhet ta paraqesin informatën (brenda institucionit ku punojnë) dhe punëdhënësi ose njëri prej eprorëve duhet t'i sigurojë mbrojtje, anonimitet dhe integritet nga çfarëdo forme e keqtrajtimit" (neni 5). Megjithatë, ligji nuk e parasheh situatën kur raportuesi mund ta denoncojë eprorin dhe/ose punëdhënësin e vet, sepse në të kundërtën eprori dhe/ose punëdhënësi mund të marrë masa ndëshkimore ndaj zyrtarit që denoncon një veprim korruptiv apo abuziv.

Së treti, por që është më e rëndësishmja, ligji nuk e qartëson mbrojtjen e identitetit të informatorit dhe as nuk e penalizon situatën kur një institucion apo zyrtar përkatës e

⁴⁶ Agjencia Kundër Korrupsion. "RAPORT: RASTET E INICIUARA PËR MOS DEKLARIM TË PASURISË DHE SANKSIONET 2010-2011." Prishtine, 2012.

⁴⁷ Qeveria e Kosovës. 07 06, 2011. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_22-te_te_Qeverise_2011.pdf (qasur me 10 11, 2012).

⁴⁸ Kuvendi i Kosovës. 08 31, 2011. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20mbrojtjen%20e%20informatorve.pdf> (qasur me 10 03, 2012).

zbulon anonimitetin e informatorit që denoncon një veprim abuziv. Në rastin e Kroacisë, ta zëmë, raportuesit janë të mbrojtur nga çfarëdolloj tentative për t'u pushuar nga puna për shkak të raportimit, ata dhe familjarët e tyre. Po ashtu, për të siguruar mbrojtjen e identitetit të raportuesve shteti kroat ka themeluar njëherazi linja telefonike falas si "Linja Etike", "Kanali i Fishkëllyesve", "Sistemi i raportimeve anonime", etj.⁴⁹ Ndërkaq, Sllovenia, bazuar në ligjin e saj për mbrojtjen e zyrtarëve që raportojnë korrupsionin, përcakton edhe shumën financiare sanksionuese në rast se identiteti i një raportuesi zbulohet: nga 400.00 deri në 4000.00 Euro për persona fizikë, ndërkaq nga 400.00 - 100,000.00 Euro për entitete juridike.⁵⁰ Prandaj, ndryshimi i këtij ligji sipas praktikave më të mira rajonale është më se i domosdoshëm, në mënyrë që zyrtarëve institucionalë që raportojnë t'u sigurohet mbrojtje e qëndrueshme.

8. Vendimi i Pestë: Ligji për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP)

Duke marrë parasysh se partitë politike janë lojtarët kryesorë të pushtetit, rregullimi i fushëveprimit të tyre ligjor është më se i domosdoshëm. Ndonëse Ligj për Financimin e Subjekteve Politike ishte miratuar në shtator të vitit 2010, një vit më vonë Qeveria e Kosovës nxori vendimin⁵¹ e saj për ta ndryshuar sërish ligjin në fjalë, i cili në dhjetor të vitit 2011 edhe është miratuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Ndryshimet e bëra kanë prekur disa fusha të rëndësishme. Derisa në ligjin paraprak "shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike nuk mund të kalonte 0,17 % të Buxhetit, në ligjin e ri kjo shumë është dyfishuar - 0,34%.⁵² Po ashtu, dispozitat ndëshkimore të ligjit të ri janë ashpërsuar më shumë krahasuar me ato të ligjit paraprak. Derisa në ligjin paraprak shuma sanksionuese është sjellë prej 3,000.00 (tremijë) euro deri në 10,000.00 (dhjetëmijë) euro, në ligjin e tanishëm është përcaktuar prej 5,000.00 (pesëmijë) euro deri në 50,000.00 euro në qoftë se:

- Pranon mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- Mban shënimet në regjistrat e veta në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji; dhe
- Nuk i përmbahet dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera në fuqi për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale (ibid).

Një dispozitë tjetër e rëndësishme është edhe ajo për mos-raportim të financave brenda afatit të përcaktuar me ligj. "Nëse një subjekt politik nuk e paraqet raportin vjetor financiar (...) humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin e ardhshëm" (neni 21, paragrafi 2).

⁴⁹ Vasiljevic, Snjezana. 2009. <http://www.whistleblowing-cee.org/countries/croatia/research/>.

⁵⁰ Association for Ethics in Public Service. "Whistleblowing Protection - Republic of Slovenia." <http://www.whistleblowing-cee.org/countries/slovenia/research/>.

⁵¹ Qeveria e Kosovës 08 03, 2011. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vend.e_mbl._29-te.pdf (qasur me 09 25, 2012).

⁵² Kuvendi i Kosovës. 12 21, 2011. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20financimin%20e%20subjekteve%20politike.pdf> (qasur me 08 19, 2012).

Në bazë të një hulumtimi nga CRINIS, legjislacioni i Republikës së Kosovës për financimin e subjekteve politike është vlerësuar me notën mesatare prej 6.6. Ekzistojnë tri kategori të vlerësimit: e pamjaftueshme (0 deri 3.3), mesatare (3.4 deri 6.7) dhe e mirë (6.8 deri 10). Rezultati i arritur nga Kosova e vë atë në kategorinë e dytë, duke e vlerësuar kështu legjislacionin për financimin e subjekteve politike si mesatar. Masat parandaluese dhe masat ndëshkuese (sanksionet) janë dy nga kategoritë që janë vlerësuar me notat më të ulëta, me një mesatare prej 3.2, respektivisht 3.3. Rezultatet për kategorinë e parë tregojnë se në sferën e financimit të subjekteve politike në Kosovë mungon infrastruktura e nevojshme ligjore që rregullon mekanizmat parandalues si për shembull ekzistimi i sistemit të centralizuar të transaksioneve bankare, ndalimi i deponimit të parave të gatshme dhe ekzistimi i masave parandaluese ndaj keqpërdorimit të resurseve qeveritare. Mirëpo, plotësimi i kornizës ligjore me dispozita që rregullojnë masat parandaluese nuk do ta zgjidhë problemin, nëse ato nuk zbatohen në praktikë. Kategoria e dytë ka të bëjë me atë se a është korniza ligjore adekuate, dhe nëse ligjet ekzistuese për financimin vjetor të subjekteve politike zbatohen si duhet në praktikë.⁵³

9. Vendimi i Gjashtë: Ndryshimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (LPKI)

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është njëri ndër ligjet bazë në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Ky ligj është miratuar për herë të parë në vitin 2007, për t'u ndryshuar sërish në vitin 2011 - pas vendimit të qeverisë.⁵⁴ Ndonëse ligji mbetet përgjithësisht i njëjtë, dy plotësim/ndryshime pozitive kanë ndodhur në ligjin e ri:

- Zvogëlimi i përqindjes së aksioneve që një zyrtar publik mund të posedojë; si dhe
- Ashpërsimi i sanksioneve në rastet kur zyrtarët publikë gjenden në konflikt interesi.

Në rastin e parë, atë të përqindjes së aksioneve, ligji i mëparshëm u ka mundësuar zyrtarëve të lartë publikë që të posedojnë aksione deri në 20 % në firmat apo ndërmarrjet e tyre private⁵⁵, ndërsa me ligjin e tanishëm ata kanë mundësi të posedojnë deri në 5 %.⁵⁶ Po ashtu, në rastet kur zyrtarët e lartë publikë gjenden në konflikt interesi ligji i mëparshëm nuk kishte paraparë ndonjë masë ndëshkimore ndaj tyre. E vetmja masë e paraparë me ligjin paraprak ka qenë 'dorëheqja', por një veprim i tillë, duke qenë tërësisht një akt i ndërgjegjes morale të njeriut, nuk mund të kategorizohet si detyrim ligjor apo masë shtrënguese. Ndërsa me ligjin e ri specifikohen dy lloj sanksionesh në rastet kur zyrtarët publikë ndodhen në konflikt interesi:

⁵³ KDI dhe Transparency International. "Legjislacioni dhe Praktikët në Financimin e Partive Politike." 2011, fq. 8.

⁵⁴ Qeveria e Kosovës. 07 13, 2011. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_23-te_te_Qeverise_2011.pdf (qasur me 08 17, 2012).

⁵⁵ Kuvendi i Kosovës. 11 2, 2007. http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2007_02-L133_al.pdf (qasur me 10 19, 2012).

⁵⁶ Kuvendi i Kosovës. 08 31, 2011. <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,678> (qasur me 09 13, 2012).

Hulumtim Politikash: Ndikimi i Vendimeve të Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit

- Ndalim i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit (Neni 20, paragrafi 2); si dhe
- Gjoha prej 500 (pesëqind) eurove deri në 2500 (dymijë e pesëqind) euro (Neni 20, paragrafi 1).

Përveç që gjykata mund të shqiptojë masën e parë - ndalim ushtrimit të funksionit publik deri në një vit, atë mund ta kërkojë edhe Agjencia Kundër Korrupsionit. Në nenin 18, paragrafi 8 specifikohet se "Në rast se një person zyrtar i lartë vazhdon të kryejë aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të fillojë procedurën për shkarkimin e tij".⁵⁷

Element tjetër pozitiv i ligjit të ri është se në rastet kur "ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë (...) nuk ka të drejtë të lidhi kontratë ose të përfitojë punë nga institucionet qendrore apo lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse. Në të kundërtën, "Agjencia duhet të kërkojë nga organi kompetent anulimin e kontratës me ndërmarrjen apo kthimin e çfarëdo përfitimi material të ndërmarrjes nga institucioni në të cilin zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse".⁵⁸

Bazuar në Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit (2011), e cila është instanca kryesore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, rezultojnë se përgjatë vitit 2011 janë evidentuar 54 raste të konfliktit të interesit. Prej tyre në 23 raste është shmangur konflikti i interesit; 13 raste kanë rezultuar pa konflikt të interesit; 7 raste kanë rezultuar me opinion; ndërsa tre (3) raste të trajtuara kanë përfunduar me shkarkim nga funksioni; dhe një (1) rast është dërguar në kundërvajtje. Raste që janë në procedurë të trajtimit dhe të pa përfunduara janë 7, të cilat janë bartur në vitin 2012.⁵⁹

⁵⁷ Ibid.

⁵⁸ Kuvendi i Kosovës. 08 31, 2011. <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,678> (qasur me 09 13, 2012).

⁵⁹ Agjencia Kundër Korrupsionit. "Raporti Vjetor i Punës." Prishtinë, 2011, fq. 28.

Rekomandime:

Vendimi I - Task-Forca Anti-Korrupsion:

- Realizimi i hulumtimeve dhe studimeve për rishikim të tërësishëm institucional, duke definuar qartë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e secilit institucion përgjegjës për luftimin e korrupsionit;
- Specializimi i Task-Forcës Anti-Korrupsion në fushën e ndjekjes dhe hetimeve të rasteve të rënda të korrupsionit, duke ndërtuar një koordinim më të mirë me prokuroritë e qarkut dhe ato komunale; si dhe
- Hapja e Task-Forcës Anti-Korrupsion, duke rritur transparencën mes prokurorëve të kësaj Task-Force, por njëkohësisht edhe në relacion me institucionet tjera dhe qytetarët.

Vendimi II - Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar:

- Specializimi i Agjencisë në administrimin e pasurive që derivojnë kryesisht nga korrupsioni, krimi i organizuar dhe shpëlarja e parasë;
- Rritja e bashkëpunimit me prokuroritë, gjykatat dhe institucionet tjera relevante.

Vendimi III - Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Dhuratave:

- Ashpërsimi i sanksioneve për mos-deklarim të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë;
- Verifikimin e deklaratave të pasurisë dhe kontrollimin e origjinës së pasurive të deklaruara;
- Përfshirjen e shoqërisë civile gjatë procesit të ndryshim-plotësimeve, dhe përfilljen e rekomandimeve të identifikuar nga sektori në fjalë.

Vendimi IV - Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve:

- Të ndryshojë emërtimi i ligjit dhe përkufizimet;
- Të identifikohet institucioni përgjegjës që pranon denoncimet e zyrtarëve publikë;
- Të krijohen linja të veçanta telefonike që do të siguronin mbrojtjen e anonimitetit të zyrtarëve që raportojnë rastet e korrupsionit;
- Të specifikohen masa më të fuqishme mbrojtëse nga ndëshkimet e mundshme që mund të marrin raportuesit e korrupsionit; si dhe
- Të përcaktohen masa sanksionuese për zyrtarët dhe institucionet të cilat e zbulojnë identitetin e raportuesve.

Vendimi V - Ligji për Financimin e Subjekteve Politike:

- Forcimi dhe zbatimi i masave sanksionuese për subjektet politike që nuk i dorëzojnë raportet e financave të tyre me kohë, ose që i dorëzojnë më informacione të pasakta; dhe
- Kontroll më i madh i subjekteve individuale dhe afariste që financojnë partitë politike gjatë kohës së fushatave të tyre; si dhe
- Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe zbatuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi VI - Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit:

- Rritjen e kohëzgjatjes së shkarkimit nga funksioni publik; dhe
- Rritjen e gjobave sanksionuese për zyrtarët që gjenden në konflikt të interesit dhe marrjen e masave të menjëhershme për shkarkimin e tyre; si dhe
- Obligimi i institucioneve që të raportojnë për rastet e konfliktit të interesit kur zyrtarët gjenden.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij Raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë ueb-faqe: www.levizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontakto:

Andrea Gropa 35, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org

“Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive”

“Supporting Good Governance and Active Citizenry”



“Andrea Gropa” nr. 35, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.+377(0)44 131 542 | www.levizjafol.org | info@levizjafol.org

